



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 57 datë 30-04 2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 119 DATË 27.11.2025 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026”

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Qendra e Artit dhe Kulturës, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtareve.

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D O S I

1. Të miratojë, ndryshimin në vendimin nr. 119 datë 27.11.2025 për “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026” si më poshtë:

6.3 QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

6.3.4 GALERIA DIGJITALE E ARTEVE

a) Përdorimi i hapësirës nga të tretët

- 1–3 orë: 30,000 lekë
- Tarifë ditore: 60,000 lekë

b) Shërbime për realizim dhe adaptim kontenti

- 2 orë - 20,000 lekë
- Për çdo 2 orë të tjera -20, 000 lekë por jo më shumë se 100,000 lekë

c) Ekspozita imersive



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

- **Deri në 1 javë:** 200,000 lekë
- **Mbi 1 javë deri në një muaj:** 350,000 lekë

d) Biletat për publikun

- Fëmije nën 13 vjeç - falas
- Persona me aftësi të kufizuar - falas
- Studente (mbi 13 vjeç, përfshirë nxënës të arsimit bazë, mesëm dhe universitar) 50 lekë/bileta
- Të moshuar - 200 lekë/bileta
- Ekspozita imersive/aktivitete kulturore (Adult) 500 lekë/bileta
- Ekspozita imersive/aktivitete kulturore të veçanta (Adult) 1000 lekë/bileta

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është Qendra Artit dhe Kulturës Korçë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Artit dhe Kulturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kundër 2

Vota Abstenim 2

Zbardhur më datë 30-04-2026

KRYETAR

Ana Verushi

